

Prot. 2211/222 K (e-k)

Datë, 22/11/2022, Tiranë

Lënda: Partia Nisma Thurje

Gjetjet nga monitorimi i KRIIK mbi aktivitetin dhe raportimin

financiar të fushatës zgjedhore të vitit 2021!

Përshëndetje,

Në zbatim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 3.11.2022 për t'ua përcjellë gjetjet e Raportit të KRIIK-ut Partive Politike si dhe duke përjashtuar gjetjet që tashmë janë përfshirë në raportin e përgatitur nga KQZ-ja, ju ridërgojmë në formë të përmbledhur dhe të personalizuar se *lidhur me subjektin NTH, KRIIK ka konstatuar se:*

- *evidentohet një numër prej 4 zyrash zgjedhore të padeklaruara;*
- *financieri i partisë ka qenë njëkohësisht edhe kandidat i këtij subjekti;*
- *10 kandidatë kanë kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi në KQZ;*
- *mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.*

Lidhur me numrin e zyrave zgjedhore

Nga monitorimi i bërë prej vëzhguesve të KRIIK rezultojnë 4 zyra zgjedhore të hapura nga ky subjekt. Nga raportet e monitoruesve të KQZ-së rezultojnë 2 zyra zgjedhore të hapura nga ky subjekt. Në raportin e vetëdeklarimit ky subjekt ka deklaruar 0 zyra zgjedhore të hapura për zgjedhjet e datës 25 prill 2021.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen koordinatat e vendndodhjes, brandimi ose jo me emër kandidati i zyrës zgjedhore, si dhe fotot përkatëse.

Vendndodhja	Bashkia	Partia	Kandidati/ja	Foto
41.317588, 19.4450892	Durrës	NTH - Partia Nisma Thurje		https://drive.google.com/file/d/1TO7SxtzAGw-FJns5m4ITdXvT0r7d1k3D/view?usp=share_link
40.7257284, 19.5568833	Fier	NTH - Partia Nisma Thurje		https://drive.google.com/file/d/1P1TcrleTDhmz35WZ0200zZmSuDOrdTX_/view?usp=share_link
40.624615, 20.782823	Korçë	NTH - Partia Nisma Thurje	Klajdi Pllaha	https://drive.google.com/file/d/1wrZWq_rWuPSw_InPqK_q8F7M0MWh3eNR/view?usp=share_link

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Vendndodhja	Bashkia	Partia	Kandidati/ja	Foto
40.456, 19.487	Vlorë	NTH - Partia Nisma Thurje	Enriko Kaçaj	https://drive.google.com/file/d/1mSrN8HbJbR0Yzq2zb6d0rFYPWQ-Akbl/view?usp=share_link

Lidhur me financierin njëkohësisht edhe kandidat

Referuar raportit të vetëdeklarimit dhe listës shumëemërore të kandidatëve të Partisë Nisma Thurje, financieri z. Panajot Soko është edhe kandidat me numër rendor 1 në Qarkun Tiranë.

Lidhur me shpenzimet e kandidatëve të NTH për reklamë politike në Facebook dhe Instagram

Për 10 kandidatë të NTH, sipas listës më poshtë rezulton se në faqet përkatëse në Facebook dhe Instagram janë paguar shuma të ndryshme për reklamë politike, por këta kandidatë nuk kanë dorëzuar një raport vetëdeklarimi në KQZ.

Për 5 kandidatë shuma e përllogaritur e paguar është 1.033 lekë, pasi ajo nuk është fikse. Kjo pasi shpenzimet e bëra nën vlerën 100 USD nuk përcaktohen me saktësi, por me rang, duke e bërë të pamundur evidentimin e vlerës së saktë të shpenzuar. Në këtë rast për efekt përllogaritjeje është marrë vlera minimale.

1. Aida Gjini ka paguar shumën 1,033 lekë.
2. Brunilda Dhrami ka paguar shumën 1,033 lekë.
3. David Velaj ka paguar shumën 1,033 lekë.
4. Denis Dema ka paguar shumën 1,033 lekë.
5. Endrit Shabani ka paguar shumën 146,202 lekë.
6. Erbi Ago ka paguar shumën 12,184 lekë.
7. Eva Xhediku ka paguar shumën 1,033 lekë.
8. Panajot Soko ka paguar shumën 56,271 lekë.
9. Rigerta Loku ka paguar shumën 12,080 lekë.
10. Rudina Hajdaraj ka paguar shumën 4,810 lekë.

Lidhur me bilancin e asetëve dhe detyrimeve

Sipas komunikimit shkresor me KQZ-në rezulton se NTH nuk ka dorëzuar bilancin e asetëve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve (pra nga data 6 shtator 2020 – 25 prill 2021), në zbatim dhe kuptim të detyrimit ligjor sipas nenit 92/3 “Deklarimi dhe publikimi” pika ç të Kodit Zgjedhor.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi me ju,

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Me konsideratë,

**Për Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

Premto Gogo

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania